



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 122

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 16 gusht 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10857, datë 31.7.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8457
Dekret i Presidentit nr. 10858, datë 31.7.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8457
Dekret i Presidentit nr. 10859, datë 31.7.2018	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 8458
Dekret i Presidentit nr. 10863, datë 7.8.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8458
Urdhër i Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018	Për miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ” 8458
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 26, datë 30.7.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018–2019” 8479
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 55, datë 20.7.2018	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Poličan..... 8501
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 56, datë 20.7.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë..... 8501

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 57, datë 20.7.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Librazhd.....	8502
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 58, datë 20.7.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Poliçan.....	8503
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 59, datë 20.7.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Gjirokastrë.....	8504

**DEKRET****Nr. 10857, datë 31.7.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Osman Ruhan Pacolli
2. Deniza Enver Pacolli (Hasani)
3. Yll Fatmir Sejdiu
4. Yllka Gani Tahiraj Sejdiu (Tahiraj)
5. Shqipo Fatmir Sejdiu
6. Fatime Ruzhdi Sejdiu (Breznica)
7. Driton Tunë Hajdaraj
8. Jak Gjok Kolgjeraj
9. Ercan Nuri Faruk Rüyal Ergül
10. Agron Tefik Novobërdaliu
11. Jakub Wojciech Waldemar Witold Szymański
12. Ibrahim Mahmoud Mohamed Ibrahim El Marakby
13. Gökhan Azmi Göç
14. Gian Carlo Gaetano Pirolo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 10858, datë 31.7.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Haki Tahir Demolli
2. Gentiana Fatmir Beqa Ahmeti (Beqa)
3. Besnik Ruzhdi Tahiri
4. Nora Blerim Luzha Tahiri (Luzha)
5. Time Haxhi Kadrijaj
6. Muharrem Qazim Nitaj
7. Hajrije Rashit Fazliu (Fazlija)
8. Islam Hysen Haxhiu
9. Teuta Bajram Haxhiu (Lekaj)
10. Haxhi Xheladin Shalaj (Shala)
11. Ali Rexhep Xhyliqi
12. Skender Vesel Hoti
13. Mujë Ibish Shala
14. Danush Ramiz Dalloshi
15. Georgios Ioannis Katantonakis
16. Douha Youssef Alhakat
17. Yumna Mahmoud Naif Alcharkat
18. Rawan Mahmoud Naif Alcharkat
19. Kujtim Salih Qerimi
20. Selami Rasim Hashani
21. Bekim Jetullah Mustafa
22. Lulzim Elez Loshi
23. Aleksander Nik Lumezi
24. Bujar Garip Lika
25. Fixhrije Musa Dragaj
26. Rasim Muhamet Selmanaj
27. Rrushe Gjemail Selmanaj (Ademaj)
28. Bekë Ramë Berisha
29. Besa Ymer Shatri Berisha (Shatri)
30. Shkumbin Bajram Demaliaj
31. Hateme Isuf Demaliaj (Osdautaj).

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**DEKRET****Nr. 10859, datë 31.7.2018****PËR LEJIMIN E LËNIES
SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Klejs Sami Seci
2. Naxhije Xhelil Krasniqi
3. Sokrat Nasi Daka
4. Alban Shaqir Shehu
5. Besjana Ram Novoviçi (Mulaj)
6. Afërdita (Aferdita) Ramazan Zaja
7. Kastriot Petrit Kasmi
8. Vjollca Kastriot Kasmi
9. Shkelzen Kastriot Kasmi
10. Ardi Sefer Bakia
11. Marsel Fatmir Uliu
12. Ormir Agron Babameto
13. Silva Besnik Et'hemaj
14. Fullanxë (Fullanxe) Kadri Kreci (Tabaku)
15. Alexandra Qazim Kreci
16. Daniel Qazim Kreci
17. Luiza Hysen Osmani (Iskurti)
18. Brend Lavdrim Osmani
19. Mimoza Ali Shpata
20. Robert (Bledar) Jashar Ramku
21. Bationa Myslim Shahollari
22. Rudina Zef Scheller (Preçi)
23. Iris Dielli Shehi
24. Gerti Myfterem Bäcker (Totolaku)
25. Olti Arjan Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 10863, datë 7.8.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lindon Erdwan Selahi
2. Shefit Ekrem Shefiti
3. Besir Nazmi Demiri
4. Drilon Ibrahim Kryeziu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

URDHËR**Nr. 25, datë 10.8.2018****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
SË INSPEKTIMEVE, SI NJË PROCES I
RREGULLT ADMINISTRATIV”**

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; nenit 16, pika 2, germa “c”, të vendimit nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit, të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik *e-Inspektimi*”; kreut III, të urdhrin nr. 432, datë 28.9.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 15/2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit *e-Inspektimi*”; të urdhrin nr. 13, datë 23.4.2015, “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe



të vendimit nr. 1, datë 12.10.2017, të zëvendëskryeministres, znj. Senida Mesi, kryetare e “Komitetit drejtues për ristrukturimin e institucioneve të varësisë” dhe akteve të tjera nënligjore,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen, Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe iu njoftohet inspektorateve shtetërore dhe trupave të tjera inspektuese.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari

RREGULLA

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË
INSPEKTIMEVE, SI NJË PROCES I
RREGULLT ADMINISTRATIV

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i Rregullores është rregullimi i ushtrimit të veprimtarisë inspektuese nga inspektoratet shtetërore, sipas ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Kodit të Procedurave Administrative, ligjeve sektoriale, akteve nënligjore dhe rregullatore në fushën e inspektimit.

2. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave për kryerjen e inspektimeve, bazuar në një procedurë administrative të rregullt ligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe shmangies së korrupsionit në fushën e veprimtarisë së inspektimeve, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm, të personave fizikë dhe juridikë, që përfshin:

a) Kryerjen e veprimtarisë inspektuese me dokumente standarde, listë verifikimi dhe kartën digjitale të inspektorit;

b) Kryerjen e inspektimeve *online*, bazuar në metodologjinë e analizës së vlerësimit të riskut;

c) Kryerjen e inspektimeve në portalin unik të inspektimeve, *e-Inspektimi* nëpërmjet paketave portable.

KREU II PROCEDURA E INSPEKTIMIT

3. Inspektimi kryhet mbi bazën e një procedimi administrativ të rregulluar nga ligji nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Kodi i Procedurave Administrative, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

4. Formatet për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, që duhet të përdoren nga inspektoratet shtetërore, janë përshtatur sipas dokumenteve standarde të përcaktuara në urdhrin nr. 58, datë 21.8.2014, të ndryshuar dhe iu janë dërguar çdo inspektorati shtetëror dhe njëkohësisht gjenden në *web-in* e Inspektoratit Qendror dhe në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

INSPEKTIMET PËR NGA FORMA E
AUTORIZIMIT DHE ORGANIZIMIT TË
TYRE NDAHEN NË:

a) INSPEKTIME TË PROGRAMUARA

b) INSPEKTIME JASHTË PROGRAMI

Një procedurë inspektimi e rregullt administrative, *e programuar apo jashtë programit*, është paraqitur në shtojcën 1 dhe shtojcën 2, të kësaj rregulloreje.

5. Plani vjetor i inspektimit hartohet nga çdo inspektorat shtetëror, mbi bazë tematike, mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin për inspektim periodik, me qëllim planifikimin sasior të akteve të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave të inspektimit përgjatë vitit kalendarik. Plani i hartuar, brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës, i paraqitet për mendim këshillimor Inspektoratit Qendror.

6. Plani mujor i inspektimit hartohet mbi bazë subjektsh, në zbatim të fushave dhe prioriteteve të përcaktuara në programin vjetor të inspektimeve dhe i paraqitet për mendim këshillimor, brenda datës 15 të muajit paraardhës, Inspektoratit Qendror.

7. Programet vjetore dhe mujore të inspektimit, të hartuara nga çdo inspektorat shtetëror, pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror, gjenerohen në portalin *e-Inspektimi*, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dita e marrjes së përgjigjes.



8. Çdo subjekt, objekt inspektimi, inspektohet sipas programit mujor të inspektimit të miratuar. *Përfshirë*, një inspektim mund të autorizohet jashtë programit mujor të inspektimit (*inspektim i posaçëm*), në rastet e përcaktuara në ligjin për inspektimin. (*Shih shtojcën 2.*)

KREU III

INSPEKTIMI ME URDHËR TË POSAÇËM

9. Kryeinspektori i drejtorisë rajonale mund të autorizojë kryerjen e një inspektimi të posaçëm. Në autorizim duhet të përcaktojë shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, kohëzgjatjen e kryerjes së inspektimit, objektin e inspektimit, emrin e subjektit dhe adresën, gjeneralitetet e inspektorëve dhe numrin e kartës digjitale të secilit. (*Kjo procedurë është e detajuar në shtojcën 2.*)

10. Kryeinspektori në nivel qendror, mund të urdhërojë kryeinspektorin e një drejtorie rajonale, të kryejë procedurë inspektimi të posaçëm, duke përcaktuar në urdhër kohën e kryerjes së inspektimit, fushën apo subjektin që do të inspektohet. Në urdhër duhet të pasqyrohet arsyeja, burimi i informacionit, që është bërë shkak për kryerjen e inspektimit të posaçëm.

11. Kryeinspektori në nivel qendror, mund të urdhërojë kryeinspektorin e drejtorisë rajonale, që të përfshijë për mbështetje, gjatë procedurës së inspektimit të posaçëm edhe inspektorë të nivelit qendror apo të një drejtorie tjetër rajonale, duke përcaktuar emrat e tyre në urdhër.

12. Autorizimi dhe e gjithë procedura e inspektimit të posaçëm, në zbatim të urdhrit të kryeinspektorit në nivel qendror, kryhet nga kryeinspektori i drejtorisë rajonale, ku do të realizohet procedura e inspektimit, sipas fazave dhe përpilimit të dokumenteve të pasqyruara në shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

13. Autorizimi për inspektim të posaçëm, plotëson të njëjtat kërkesa ligjore si autorizimi për inspektim të programuar, por shoqërohet me urdhrin e kryeinspektorit në nivel qendror, si dhe dokumentet justifikuese bashkëlidhur.

KREU IV

KORRIGJIMI DHE NDJEKJA E SHKELJEVE TË LËNA NGA INSPEKTIMI

14. Në rastet e inspektimeve të programuara, subjekti, objekt inspektimi urdhërohet të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore.

15. Subjekti, objekt inspektimi, është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit, të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

16. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese, kryhet një inspektim i ri. Në rastet kur nga riinspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.

17. Procedura e inspektimit dhe riinspektimit kryhen *online* në portalin *e-Inspektimi*.

KREU V

MARRJA E MOSTRAVE

18. Trupat inspektuese të inspektorateve shtetërore, bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 35, pika 1, kanë të drejtë të marrin pa pagesë, mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t’ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave.

19. Mostrat merren në prani të përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, përveç rasteve kur ai është përjashtuar me vendim, nga të qenit i pranishëm gjatë inspektimit. Përpara zgjedhjes së mostrave, trupa inspektuese i shpjegon përfaqësuesit të subjektit, procedurën e marrjes së tyre.

20. Gjatë inspektimit, trupa inspektuese argumenton në procesverbalin e inspektimit arsyen e kryerjes së verifikimeve të mëtejshme dokumentare apo marrjen e mostrave për analizë, që shoqërohet me marrjen e masës urgjente, me karakter të ndërmjetëm, deri në një vendim përfundimtar.



21. Marrja e mostrave, pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Trupa inspektuese e mbyll procesverbalin pa marrë vendim përfundimtar, deri në marrjen e rezultatit të ekspertizës apo të ekzaminimit nga laboratorit. Subjekti riinspektohet brenda 4 ditëve, nga data e marrjes së përgjigjes së analizave.

22. Pas marrjes së rezultatit të analizave, procesverbali i inspektimit rihapet në sistemin *online e-Inspektimi* dhe merret vendim përfundimtar pranë dhe në prezencë të subjektit, objekt inspektimi, bazuar në gjetjet e pasqyruara në procesverbalin e inspektimit dhe rezultatin e analizave të mostrave të marra.

23. Procedura e përshkruar në këtë krye, duhet të ndiqet edhe në rastet e inspektimeve të planifikuara, ku objekt i inspektimit të trupave të inspektimit, për disa inspektorate shtetërore, është edhe zbatimi i planeve të marrjes së mostrave për analizë.

KREU VI

MARRJA E VENDIMIT TË NDËRMJETËM

24. Masa urgjente merret nga trupa inspektuese gjatë inspektimit, me vendim të ndërmjetëm kur, për shkak të shkeljes së konstatuar të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik apo i palëve të treta, veçanërisht kur është e nevojshme për të shmangur një rrezik të menjëhershëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve a për mjedisin;

a) Ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga e cila mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm, i interesit publik apo palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo e analizave.

25. Vendimi i ndërmjetëm për masën urgjente, pasqyrohet në një akt të shkruar dhe i njoftohet subjektit të interesuar, brenda 24 orëve.

a) Trupa inspektuese, verbalisht dhe në akt, i njofton subjektin të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të ndërmjetëm.

26. Kundër vendimit të ndërmjetëm, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë tek

organi kompetent, i cili ka lëshuar aktin administrativ.

27. Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit, pa vonesë, në mënyrë verbale, ndërkohë që një akt i shkruar me të njëjtën përmbajtje njoftohet me shkrim brenda 24 orëve. Masat urgjente mund të merren deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar.

28. Vendimi i ndërmjetëm përfundon sipas parashikimeve të përcaktuara në ligjin për inspektimin.

29. Ankimi i veçantë është pjesë e procedurave të ankimit administrativ të inspektimit dhe e drejtë për t'u ushtruar nga subjekti gjatë procedurës së inspektimit, në rastet kur trupa inspektuese ka marrë masë urgjente. Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë sipas formatit "Ankim i veçantë", i cili mund të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm, duke iu drejtuar me shkrim kryeinspektorit të drejtorisë rajonale dhe për inspektoratet e qendëruara, kryeinspektorit të inspektoratit shtetëror.

KREU VII

MARRJA E VENDIMIT PËRFUNDIMTAR

30. Në rastet kur nuk janë konstatuar shkelje, vendimi përfundimtar i inspektimit është pjesë e procesverbalit të inspektimit dhe pas printimit nënshkruhet nga trupa e inspektimit dhe përfaqësuesi i subjektit të inspektuar në vendin ku është kryer inspektimi, duke i lënë këtij të fundit një kopje të procesverbalit.

31. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore gjatë procedurës së inspektimit ose riinspektimit, trupa inspektuese mbyll procesverbalin dhe merr vendim përfundimtar aty për aty, për rastet e parashikuara në ligjet sektoriale. Procesverbali dhe vendimi përfundimtar mbahet në vendin e inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa inspektuese dhe subjekti.

32. Për rastet kur janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, që mund të shkaktjnë një dëm të menjëhershëm, të rëndë dhe të pariparueshëm, të interesit publik, si edhe kur ligjet sektoriale parashikojnë masa administrative për shkeljen e konstatuar, trupa inspektuese përpilon



procesverbalin dhe vendimin e ndërmjetëm. Procesverbali dhe vendimi i ndërmjetëm mbahet në vendin e inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa inspektuese dhe subjekti.

33. Në rast të refuzimit të firmës nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar, brenda 24 orëve, trupa inspektuese dërgon procesverbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar, me postë në adresën e subjektit të inspektuar. Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar, subjekti ka të drejtë të ankohet me shkrim kundër vendimit përfundimtar, te Trupa Kolegjiale e inspektoratit shtetëror përkatës.

34. Trupa Kolegjiale shqyrton ankimin brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit dhe vendimit përfundimtar. ***Shqyrtimi i ankimit detyrues kryhet në prani të subjektit ankimes.*** Njoftimi i subjektit për datën dhe vendin e shqyrtimit të ankimit të tij, bëhet sipas procedurës së pasqyruar në kolonën 3 të shtojcës 1, të kësaj rregulloreje. Krijimi dhe funksionimi i Trupës Kolegjiale, përcaktohet sipas ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve sektoriale. Vendimi i Trupës Kolegjiale është i formës së prerë dhe mund të ankimohet vetëm në gjykatë.

35. Të gjitha etapat e dokumentuara gjatë shqyrtimit të procedurës së ankimit nga Trupa Kolegjiale, ngarkohen në sistemin *online e-Inspektimi*, nga sekretari dhe juristi i Trupës Kolegjiale.

KREU VIII

PROCEDURA E ANKIMIT NË GJYKATË

36. ***KUNDËR VENDIMIT TË TRUPËS KOLEGJIALE***, që është vendim përfundimtar, subjekti ka të drejtë që brenda 45 ditëve të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

KREU IX

PËRDORUESIT E AUTORIZUAR TË PORTALIT

37. Çdo procedurë administrative që ka të bëjë me funksionet inspektuese, duhet të pasqyrohet nga përdoruesit e autorizuar të portalit, në sistemin elektronik të inspektimeve *e-Faqe* | 8462

Inspektimi, referuar pikave 6–15, të nenit 11, të urdhrit nr. 432, datë 28.9.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 15/2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit *e-Inspektimi*.”

38. Përdoruesit e autorizuar mbajnë përgjegjësi për respektimin e afateve kohore dhe procedurave, të përcaktuara për t’u bërë me mjete elektronike në portal, sipas ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit *unik e-Inspektimi*, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

39. Kjo rregullore është e detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese në Republikën e Shqipërisë. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje sjell përgjegjësi administrative dhe penale.

40. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

KREU XI

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



SHTOJCA 1

PROCEDURA ADMINISTRATIVE E INSPEKTIMIT TË PROGRAMUAR						
1	2	3	4	5	6	7
Procedura administrative e inspektimit autorizohet nëpërmjet gjenerimit të tij në portalin unik të inspektimit. Autorizimi të plotësohet në të gjitha rubrikat dhe nënshkruhet e timbrohet, si akt administrativ i vlefshëm ligjor sipas formatit të miratuar nga Inspektorati Qendror. Autorizimi printohet në dy kopje, nënshkruhet dhe timbrohet nga kryeinspektori i inspektoratit shtetëror të qendëruar ose nga kryeinspektori i drejtorisë rajonale të inspektorateve shtetërore jo të qendëruara.	Autorizimi i inspektimit i njoftohet subjektit, objekt inspektimi, nëpërmjet dorëzimit paraprak të njoftimit, jo më vonë se 7 ditë nga dita e përpilimit të aktit administrativ “autorizimi”.	Dokumentimi i marrjes së njoftimit paraprak të autorizimit nga subjekti për kryerjen e inspektimit, bëhet duke shkruar në subjekt nga një person përgjegjës dhe lënies së një kopjeje të autorizimit përfaqësuesit të subjektit, objekt inspektimi. Ky i fundit nënshkruan marrjen në dëgjim të kopja e autorizimit të trupës inspektuese.	Në rast të refuzimit të marrjes së autorizimit apo mosgjatjes së personit përfaqësues, personi përgjegjës e afishon autorizimin në vendin ku do kryhet inspektimi dhe ky fakt pasqyrohet në kopjen e autorizimit të trupës inspektuese.	Veprimtaria inspektuese realizohet në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në autorizim dhe çdo veprim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim, nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore trupën inspektuese përkatëse.	Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar bazohen në gjetjet e konstatuara gjatë verifikimit të listës së verifikimit (<i>check list</i>). Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar apo vendimi i ndërmjetëm, nënshkruhen nga trupa e inspektimit dhe nga përfaqësuesi i subjektit objekt inspektimi, në vendin ku kryhet inspektimi.	* Procesverbali i inspektimit plotësohet në të gjitha rubrikat, gjatë punës në terren nga trupa inspektuese, e cila kryen inspektimin, si dhe mban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Trupa inspektuese duhet të pasqyrojë në procesverbal pretendimet e subjektit, objekt inspektimi mbi gjetjet e konstatuara përpara se të përpilojë procesverbalin dhe vendimin përfundimtar. * Njoftimi i procesverbalit të inspektimit, vendimit përfundimtar, si dhe vendimit të ndërmjetëm, mbahen në subjekt, në përfundim të veprimtarisë inspektuese. * Në mbyllje të procesverbalit të inspektimit dhe të vendimit përfundimtar, si dhe vendimit të ndërmjetëm, bëhet formalizimi i procedurës, duke nënshkruar trupa inspektuese dhe subjekti, duke i lënë këtij të fundit një kopje të dy akteve të nënshkruara. * Nëse subjekti nuk bie dakord për nënshkrimin e procesverbalit dhe të vendimit përfundimtar apo vendimit të ndërmjetëm, kjo pasqyrohet nga trupa inspektuese me shënimin “Refuzon firmën” dhe brenda 24 orëve procesverbali dhe vendimi përfundimtar i dërgohen subjektit të inspektuar me postë, në adresën e tij, duke pasur të njëjtën fuqi juridike si të jenë nënshkruar rregullisht nga ai. * Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi ose dërgimi me postë i procesverbalit dhe të vendimit përfundimtar, subjektit i lind e drejta e ankimit të këtij vendimi në Organin Kolegjial, të ngritur pranë Inspektoratit Shtetëror. Brenda 15 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit të subjektit, por jo më vonë se 30 ditë shqyrtohet ankimi dhe vendimi i Trupës Kolegjiale është vendim përfundimtar. * KUNDËR VENDIMIT TË TRUPËS KOLEGJIALE, që është vendim përfundimtar, subjekti ka të drejtë që brenda 45 ditëve të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodin e Procedurave Administrative.
8						
Autorizimi, marrja e njoftimit të autorizimit, lista e verifikimit, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar, vendimi i ndërmjetëm, dokumentacioni justifikues, marrja e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal, marrja e njoftimit të vendimit përfundimtar, përgjigjet e rezulttit të analizave dhe çdo dokument tjetër i administruar në dosjen e inspektimit (prova materiale, fotografime, filmime), i nënshkruar dhe timbruar, të ngarkohen në portal , në dosjen përkatëse.						



SHTOJCA 2

PROCEDURA ADMINISTRATIVE E INSPEKTIMEVE JASHTË PROGRAMIT				
1	2	3	4	5
Inspektim jashtë programit konsiderohet “inspektim i posaçëm” dhe fillon në bazë të: 1. Urdhrit të kryeinspektorit në nivel qendror, për kryeinspektorin e drejtorisë rajonale. 2. Me autorizimin e kryeinspektorit të inspektoratit shtetëror të qendëruar. 3. Me autorizimin e kryeinspektorit të drejtorisë rajonale. 4. Inspektimi i posaçëm bëhet pa njoftim paraprak të subjektit të përcaktuar në autorizim.	Autorizimi i inspektimit i njoftohet subjektit, objekt inspektimi, me paraqitjen e trupës inspektuese pranë tij.	Veprimtaria inspektuese realizohet në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në autorizim dhe çdo veprim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim, nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore trupën inspektuese përkatëse.	Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar bazohen në gjetjet e konstatuara gjatë verifikimit të listës së verifikimit (<i>check list</i>). Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar nënshkruhen nga trupa e inspektimit dhe nga përfaqësuesi i subjektit objekt inspektimi, në vendin ku kryhet inspektimi.	* Procesverbali i inspektimit plotësohet në të gjitha rubrikat, gjatë punës në terren nga trupa inspektuese, e cila kryen inspektimin, si dhe mban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Trupa inspektuese duhet të pasqyrojë në procesverbal pretendimet e subjektit, objekt inspektimi, mbi gjetjet e konstatuara përpara se të përpilojë procesverbalin dhe vendimin përfundimtar. * Njoftimi i procesverbalit të inspektimit dhe vendimi përfundimtar apo vendimi i ndërmjetëm, mbahen në subjekt, në përfundim të veprimtarisë inspektuese. * Në mbyllje të procesverbalit të inspektimit, vendimit përfundimtar dhe vendimit të ndërmjetëm, bëhet formalizimi i procedurës, duke nënshkruar trupa inspektuese dhe subjekti, duke i lënë këtij të fundit një kopje të dy akteve të nënshkruara. * Nëse subjekti nuk bie dakord për nënshkrimin e procesverbalit dhe vendimit përfundimtar, kjo pasqyrohet nga trupa inspektuese me shënimin “Refuzon firmën” dhe brenda 24 orëve procesverbali dhe vendimi përfundimtar i dërgohen subjektit të inspektuar me postë në adresën e tij, duke pasur të njëjtën fuqi juridike si të jenë nënshkruar rregullisht nga ai. * Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi ose dërgimi me postë i procesverbalit dhe vendimit përfundimtar, subjektit i lind e drejta e ankimit të këtij vendimi në Organin Kolegjial, të ngritur pranë Inspektoratit Shtetëror. Brenda 15 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit të subjektit, por jo më vonë se 30 ditë shqyrtohet ankimi dhe vendimi i Trupës Kolegjiale është vendim përfundimtar. * KUNDËR VENDIMIT TË TRUPËS KOLEGJIALE, që është vendim përfundimtar, subjekti ka të drejtë që brenda 45 ditëve të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodin e Procedurave Administrative.
6				
Autorizimi, marrja e njoftimit të autorizimit, lista e verifikimit, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar, dokumentacioni justifikues, marrja e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal, marrja e njoftimit të vendimit përfundimtar, përgjigjet e rezultatit të analizave dhe çdo dokument tjetër i administruar në dosjen e inspektimit (prova materiale, fotografime, filmime), i nënshkruar dhe timbuar, të ngarkohen në portal , në dosjen përkatëse.				



ANEKSI NR. 1
DOKUMENTET E INSPEKTIMIT DHE KARTA E INSPEKTORIT

Më poshtë gjenden formatet standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë, në formatin *Word*:

1. Autorizim inspektimi;
2. Procesverbal inspektimi;
3. Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente;
4. Vendim përfundimtar inspektimi;
5. Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë;
6. Autorizim për ndryshimin e inspektorëve;
7. Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektorit;
8. Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
9. Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
10. Vendim i Komisionit të Ankimit;
11. Karta e inspektorit.

FORMATET STANDARDE PËR DOKUMENTIMIN E VEPRIMTARISË
SË INSPEKTIMIT – ANEKS

Formati nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DEGA RAJONALE E QARKUT _____
AUTORIZIM INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/A

Datë ____./____./____

Bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së për krijimin e inspektoratit shtetëror përkatës autorizoj inspektimin e

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: *(Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)*_____

Inspektorët shtetërorë të autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

si dhe persona të tjerë të autorizuar;

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kohëzgjatja e inspektimit: _____

*(Me selektim në sistem: 1/2, 1 e 1/2 – 15 ditë)*_____
*(ora, data e fillimit)*_____
(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit: Po ☐ Jo ☐

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: (neni 32, pika 2, shkronjat “a”–“d”, gjenerohet nga sistemi. Në rastin e shkronjës “a”, vendimi i mosnjoftimit paraprak motivohet, ndërsa në rastin e shkronjës “b”, evidentohet përcaktimi i ligjit të posaçëm që lejon mosnjoftimin paraprak të inspektimit) _____

KRYEINSPEKTORI
(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)_____
Nënshkrimi, vula e institucionit



Formati nr. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DEGA RAJONALE E QARKUT _____

PROCESVERBAL INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/PV

Datë ____.

Bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: *(gjenerohen nga sistemi, autorizimi)*_____
*(ora, data e fillimit)*_____
(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Njoftim paraprak lënë subjektit: Po ☐ Jo ☐Inspektim me autorizim: Po ☐ Jo ☐*(N.q.s. “Jo”, do të zgjidhet nga sistemi një nga germat e nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 10 443)*Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar: Po ☐ Jo ☐

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po ☐ Jo ☐*(N.q.s. “Po” të plotësohet si më poshtë arsyetimi sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit dhe të ketë hapësirë për ngarkim dokumenti shpenzimi)*

Përfundimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit:

Po ☐ Jo ☐*(N.q.s. “Po” të plotësohet si më poshtë)*

Arsyetimi i përfundimit:

Procesverbali mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.

**Masa urgjente:**Po ☐ Jo ☐

(N.q.s. "Po" të plotësohet si më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm në sistem)

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT**1. Mostra të marra:**Po ☐ Jo ☐

(n.q.s. Po më poshtë do të gjenerohet nga sistemi tabelat e mëposhtme në varësi të inspektoratit shtetëror përkatës)

TABELA E MARRJES SË MOSTRAVE**TABELA (për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive)****2. Dokumente të marra:**

Nr.	DOKUMENTI I MARRË DHE PËRSHKRIMI	NR. I FLETËVE
1		
2		

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni: (ngarkohet në sistem)

Nr.	DOKUMENTI I SEKUESTRUAR DHE PËRSHKRIMI	NR. I FLETËVE
1		
2		

4. Detyra të parealizuar nga inspektimi i mëparshëm:

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e inspektoritPo ☐ Jo ☐

(Nenin 33, pikat 1/b dhe 2 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në RSH", si dhe parashikimit të ligjit të veçantë)

Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit _____, në datën _____._____,
 ora _____, të paraqitet në adresën: _____, për vazhdimin e procedurës së inspektimit.

Procesverbali mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqisni:

Dokumente të paraqitura:

Nr.	DOKUMENTI DHE PËRSHKRIMI	NR. I FLETËVE
1		
2		

Sende të paraqitura:

Nr.	SENDI DHE PËRSHKRIMI	COPE
1		
2		

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror, referuar nenit 54, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në RSH”.

7. Gjetjet e konstatuara

Ka shkelje të kërkesave ligjore: Po ☐ Jo ☐

(N.q.s. “Jo”, ky procesverbal konsiderohet edhe si vendim përfundimtar)

(N.q.s. “Po” të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

7/1. Gjetjet e konstatuara për zbatimin e [ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar](#).

Po ☐ Jo ☐

Bashkëlidhur lista e verifikimit për zbatimin e ligjit nr. 76/2014, i plotësuar gjatë inspektimit.

8. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose me gojë, pranë inspektoratit shtetëror, brenda __ ditëve nga data e njoftimit të këtij procesverbal.

Me përfundimin e këtij afati, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit.

Bashkëlidhur lista e verifikimit e plotësuar gjatë inspektimit.

Procesverbali mbahet në tri kopje dhe nënskruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsytet e përfundimit të procedimit.

III. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. __, datë __. __. ____ nenit/eve ____ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
 - a. _____;
 - b. _____;
2. Dënim administrativ plotësues:
 - a. _____;
 - b. _____;
 - c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur fleta shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë

Po ☐ Jo ☐

Nëse "Po" vendimi përfundimtar ngarkohet në sistem.

Nëse "Jo" vendimi përfundimtar kur nuk janë konstatuar shkelje ligjore, pasqyrohet më poshtë:

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot, në datën __. __. ____ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët shtetëror /ë

Personi i autorizuar nga subjekti

Procesverbali i njoftohet subjektit, brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit

Procesverbali mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Formati 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI I NDËRMJETËM
PËR MARRJEN E MASËS URGJENTE

Nr. III/00000007/VN

Datë ____.

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja : _____

Emri i punëdhënësit: _____

Në bazë të gurmës _____ (“a” ose “b”, në varësi të rastit përzgjidhet nga sistemi), të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, merret masa urgjente si më poshtë: (gërmat nga “a”–“e”, të pikës 2, të nenit 43, përzgjidhen nga sistemi).

Kohëzgjatja e afatit të masës urgjente:

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Shënim.

Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat i tillë, me:

- Njoftimin e revokimit të tij;
- Njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
- Skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
- Njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;
- Skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;
- Urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

* Ky vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente njoftohet brenda 24 orëve.

** Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij. Ankimi i veçantë paraqitet pranë degës territoriale të inspektoratit shtetëror përkatës.



Formati 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë _____.____._____

Bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. _____, datë _____.____._____, të zhvilluar në subjektin _____

prej datës _____.____._____ deri më datën _____.____._____.

(kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën _____.____._____/_____.____._____ dhe e njoftoi në datë _____.____._____.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore *(emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës, të cilat merren nga procesverbali i inspektimit)*:

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit/ve nr. ____ nenit/eve _____, pikës _____, germës _____, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor: *(përzgjidhen nga sistemi)*
 - a. _____;
2. Dënim administrativ plotësues: *(përzgjidhen nga sistemi)*
 - a. _____;
 - b. _____;

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive: *(përzgjidhen nga sistemi)*

Ngarkohet në sistem fleta shoqëruese e kësbillimit me shkrim për subjektin për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. *(Sipas VKM-së përkatëse për marrjen e mostrave, me përzgjedhje nga sistemi.)*

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

1. _____ ID: _____
2. _____ ID: _____

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti _____ ka të drejtën e ankimit brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.

Ankimi paraqitet pranë “organit epror” të Inspektoratit Shtetëror të xxx.

Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.



Formati 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

**VENDIMI
PËR ZGJIDHJEN E ANKIMIT TË VEÇANTË**

Nr. III/00000007/VP

Datë ____.

(Emërtimi i inspektoratit shtetëror)

(Në rast të degëve territoriale - dega)

Në bazë të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimit të veçantë nr. _____, datë _____, të subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar) (kjo pjesa plotësohet nga sistemi).

Pasi shqyrtova ankesën e këtij subjekti dhe masën urgjente të marrë,

VENDOS:

1. Lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm dhe rrëzimin e ankimit të veçantë
2. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm dhe pranimin e ankimit të veçantë
3. Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm, duke pranuar pjesërisht ankimin

☐
☐
☐

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi (nëse zgjidhet opsioni 1)/ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2)/ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse (gjenerohet nga sistemi germa nga “a” në “e”, të pikës 2, të nenit 43, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”).

KRYEINSPEKTORI
(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

Nënshkrimi, vula e institucionit

Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit të veçantë mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



Formati 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

AUTORIZIM PËR NDRYSHIMIN E
INSPEKTORËVE

Nr. III/00000007/A

Data _____

(Emërtimi i inspektoratit shtetëror)

(Në rast të degëve territoriale - dega)

Ndryshime në autorizimin nr., datë *(të gjenerohet nga sistemi autorizimi të cilit i referohet)*

Baza ligjore: neni 30, pika 3, e ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në RSH”.

Inspektori/ët e autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Zëvendësohen me inspektorin/ët e autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Persona të tjerë të autorizuar:

1. _____

2. _____

Zëvendësohen me:

1. _____

2. _____

KRYEINSPEKTORI

(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

Nënskrimi, vula e institucionit

Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit.



Formati 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

KËRKESË PËR REFUZIM TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Drejtuar: z/znj. _____

Kryeinspektor (sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

Kërkesë për refuzim të autorizimit nr.____, datë _____ (plotësohet nga sistemi)

Bazuar në pikën 3, të nenit 30, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet refuzimi i autorizimit nr. _____, datë _____, për arsye, si më poshtë:

1. Konflikt interesi
2. Programim në ...
3. Leje vjetore
4. Paaftësi e përkohshme
5. Etj.

Inspektori shtetëror:

1. _____ ID: _____

Nënshkrimi, data



Formati 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

KËRKESE PËR SHTYRJE TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Drejtuar: Z/Znj. _____

Kryeinspektor (sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

Kërkesë për shtyrje të autorizimit nr.____, datë_____

Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet shtyrje e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me: _____

(me selektim në sistem: 1/2, 1 e 1/2 - 15 ditë)

(data e fillimit)

(data e përfundimit)

* Shënim. Kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare.

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektorët shtetërorë:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Vendimi i njoftohet subjektit të inspektimit përpara skadimit të kohëzgjatjes dhe nuk mund të ankimohet veçmas.



Formati 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIM PËR SHTYRJE
TË AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në RSH” dhe kërkesën nr.____, datë____ (nga sistemi kërkesa e paraqitur nga inspektori shtetëror) autorizoj/nuk autorizoj shtyrjen e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: (sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

(Nëse jepet autorizim për shtyrje të afatit)

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me (selektim në sistem) _____
(data e fillimit) (data e përfundimit)

Shënim. Kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare.

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

KRYEINSPEKTORI
(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

Nënshkrimi, vulë e institucionit



Formati nr. 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI
I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Nr. III/00000007/VP Datë _____.____._____

Emërtimi i Komisionit të Ankimit _____
(emërtimi i inspektoratit shtetëror)

Emri i subjektit që është ankuar, të cilit i referohet vendimi përfundimtar *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. _____, datë _____.____._____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar) *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*.

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë *(shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ)*, Komisionit i Ankimit

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar

Për sa më sipër urdhëroj lënien (nëse zgjidhet opsioni 1)/ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2)/ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse *(gjenerohet nga sistemi masa e marrë)*. ☐

KRYEINSPEKTORI
(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)


Nënshkrimi, vula e institucionit

Kundër vendimit të Komisionit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.




KARTA INSPEKTOR

(Pjesa Para)

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË EMRI INSPEKTORATIT SHTETËROR	
	
KARTË INSPEKTORI	
Emër Mbiemër: Xxxxx XXXXXX	
Pozicioni:	Inspektor i punës
Kodi:	00001
Data e lëshimit: xx.xx.2016	

(Pjesa Mbrapa)

 INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM Shkëlqim HAJDARI	
Firma _____	
 Vula IO	
Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë Inspektoratit Qendror.	
info@insq.gov.al www.inspektoratiqendror.gov.al	

UDHËZIM

Nr. 26, datë 30.7.2018

**PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18,
DATË 21.5.2018, “PËR PROCEDURAT E
APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE, NË PROGRAMET E
STUDIMEVE ME KARAKTER
PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET
E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN
AKADEMIK 2018–2019”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. Titulli i udhëzimit nr. 18, datë 21.5.2018, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018–2019”, ndryshon si më poshtë:

“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018–2019”.

II. Pas kreut IV të udhëzimit shtohet kreu IV/1, si më poshtë:

“Kreu IV/1

Procedurat e pranimi dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara



***të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë,
në institucionet e arsimit të lartë, për vitin
akademik 2018–2019***

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 3 shtator 2018 deri në datën 14 shtator 2018.

2. Kandidatët që aplikojnë në LAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo për transferim studimesh të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

4. Kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar si program i dytë apo për transferim studimesh në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në e sipërcituar.

5. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

6. Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në LAL-të publike ose në LAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendëse apo të huaja.

7. Nuk kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh ish-studentët e institucioneve të arsimit të lartë të mbyllura me vendimin nr. 539, datë 6.8.2014, të

Këshillit të Ministrave, “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë” dhe të institucioneve të arsimit të lartë që nuk u hoq masa e pezullimit e dhënë nga vendimi nr. 540, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e veprimtarisë së disa institucioneve private të arsimit të lartë”.

Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh, vetëm për vitin akademik 2018–2019, ish-studentët e shkollës së lartë universitare, jopublike “Justicia”, Tiranë, të mbyllur me vendimin nr. 70, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike “Justicia”, Tiranë.

8. Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër, nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë Bachelor dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë “master i shkencave”.

9. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:

a) Kërkesa drejtuar LAL-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 7);

b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.

Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t’i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin;

d) Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;



e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Dy fotografi personale;

g) Kopje e mandatpagesës.

10. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në LAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit për qëllim transferimi, nga LAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. emrin, atësinë, mbiemrin;

ii. datëlindjen;

iii. vendlindjen;

iv. shtetësinë;

v. numrin e matrikullimit që ka pasur në LAL-në përjellëse;

vi. emrin e shkollës së mesme/LAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

vii. ID e Maturës Shtetërore/nr. regj. të veçantë¹;

viii. numrin personal të identitetit;

ix. datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga LAL-ja;

x. emërtimin e programit të studimit dhe fakulteti përkatës;

xi. ciklin dhe formën e studimit;

xii. datën e ndërprerjes së studimeve.

11. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesa drejtuar LAL-së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (formulari i aplikimit sipas shtojcës 7);

b) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);

d) Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë publikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse ose listën e

notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Dy fotografi personale.

Njohja e dokumentacionit të kandidatëve shtetas të huaj fitues, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

12. LAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 17 shtator 2018.

13. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga LAL-ja brenda datës 24 shtator 2018. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, i cili shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të LAL-së, si dhe faqet web përkatëse, e plotësuar sipas tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në shtojcën nr. 8 të këtij udhëzimi.

LAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 25 shtator 2018. Në listën e publikuar nga ana e LAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

14. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në LAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. LAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

15. LAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet web zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 3 tetor 2018.

Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 6 tetor 2018 deri në datën 12 tetor 2018, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2018.

16. LAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve

¹ Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.



të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga LAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.”.

III. Pas kreut IV/1 të udhëzimit, shtohet kreu IV/2, si më poshtë:

“Kreu IV/2

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (LAL), nga data 10–24 gusht 2018, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga LAL-ja.

2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë LAL-ve respektive, deri në datën 24 gusht 2018. Në të njëjtën datë, LAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, e cila bëhet publike në mjediset e LAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datën 27 gusht 2018.

3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në vendimin nr. 216, datë 20.4.2018, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të

lartë, për vitin akademik 2018–2019”, si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimin të vendosura nga vetë LAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë. Përfshihen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa LAL.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të LAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të LAL-së pranë të cilit aplikon.

6. Aplikimi për programet e studimit në LAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njëjës kryesore të LAL-ve.

7. Sekretaritet mësimore mbajnë regjister për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllëgarit mesataren për çdo kandidat në përputhje me vendimin nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”. Për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen zyrtarisht nga sekretaritet mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

8. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja:

i. formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 3;
ii. kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave;

iii. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë LAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij



udhëzimi (shtojca nr. 5), si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet. Përlllogaritja e notave do të kryhet sipas udhëzimit nr. 44, datë 21.8.2013 të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", të ndryshuar. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore;

iv. dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

v. dy fotografi;

vi. kopje e mandatpagesës.

b) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian:

i. formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

ii. kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave;

iii. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë LAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (shtojca nr. 5), si dhe kopje të njëzuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njëzuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore) përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

iv. fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

v. dy fotografi personale;

vi. kopje e mandatpagesës.

c) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njëzuar me origjinalin e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

d) Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të dorëzojnë edhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

e) Kandidatët nga komuniteti rom dhe egjiptian, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të dorëzojnë edhe vetë deklarin ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, LAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

f) Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8.b, duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

9. LAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. LAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. LAL-të në datën 5 shtator 2018 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda tri ditëve kalendrike nga data e shpalljes së rezultateve. LAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e LAL-ve ankohen në gjykatën kompetente.

11. LAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 shtator 2018, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.



12. Kandidatët regjistrohesh vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2018.

13. Pas datës 19 shtator 2018, sekretarët mësimorë në njësitë kryesore të LAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë zyrtarisht kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

14. LAL-të, brenda datës 6 tetor 2018, përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuara në momentin e aplikimit.

15. LAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga LAL-ja çregjistrimin tyre.”.

IV. Pas kreut IV/2 të udhëzimit, shtohet kreu IV/3, si më poshtë:

“Kreu IV/3

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (LAL), nga data 20–30 gusht 2018, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga LAL-ja.

2. Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në LAL-të publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e

arsimit të lartë, për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

3. Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të LAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të LAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

4. Kandidatët shtetas të huaj që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në vendimin nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave.

5. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa LAL.

6. Studentët e huaj duhet të paraqesin pranë LAL-ve dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, lehtënjostim ose pasaportë);

c) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe;

d) Dy fotografi personale;

e) Kopje e mandatpagesës;

f) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. LAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuar nga ana e tyre. LAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. LAL-të në datën 4 shtator 2018 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jopërfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda tri ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. LAL-të detyrohen të shprehin me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e LAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.



9. LAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 shtator 2018, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Kandidatët regjistren vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2018. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të beqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.

11. Pas datës 19 shtator 2018, sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore të LAL-ve, për kuota të paplotësuara, njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

12. LAL-të, brenda datës 6 tetor 2018, përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.

13. Sekretaritetë mësimore të LAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues, sipas dokumenteve të dorëzuara në momentin e aplikimit.

14. Procedurat e regjistrimit për programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar:

a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në LAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me LAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga vetë LAL-të.

b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen pajisjen e tyre me NiM dhe brenda datës 26 janar 2018 ia komunikon zyrtarisht LAL-së.

c) Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë LAL-së përkatëse. Të dhënat e tyre u dërgohen QSHA-së nga LAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, LAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.

d) Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dytë i LAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe, sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

e) Sekretaritetë mësimore të LAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

f) LAL-të, brenda datës 12 nëntor 2018, dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matricullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matricullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga LAL-ja regjistrimin tyre."

V. Pas kreut IV/3 të udhëzimit, shtohet kreu IV/4, si më poshtë:

"Kreu IV/4

Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "master profesional" dhe "master i shkencave"/"master i arteve"

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore, në LAL-të publike deri në datën 12 tetor 2018 dhe në LAL-të jopublike deri në datën 19 tetor 2018.

2. Brenda datës 22 tetor 2018, LAL-të publike dhe brenda datës 29 tetor 2018 LAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, si dhe në faqet web të LAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuota të pranimeve, të miratuara.

3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në LAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. LAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive



mësimore përkatëse të LAL-së publike deri në datën 30 tetor 2018 dhe deri në datën 6.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të LAL-së jopublike.

5. LAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj web, listën emërore të kandidatëve të regjistruar, brenda datës 1 nëntor 2018 për LAL-të publike dhe 8 nëntor 2018 për LAL-të jopublike.

6. Njësitë kryesore të LAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

7. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “master profesional” dhe “master i shkencave”/ “master i arteve të bukura”, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018–2019, sipas kuotave respektive të deklaruara nga LAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga LAL-të, konform akteve ligjore e nënlige në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, brenda muajit dhjetor 2018.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

b) Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuara me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar

shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

c) Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi);

d) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

e) Dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

Shtetasit e huaj që aplikojnë, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe, përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

b) Curriculum Vitae;

c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

c) Kandidati nga komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.



12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të LAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga LAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë LAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga LAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në LAL-në publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i kërkon LAL-ve ta regjistrojë atë.

15. LAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe LAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. LAL-të, brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matricullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matricullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga LAL-ja regjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.”

VI. Pas kreut IV/4 të udhëzimit, shtohet kreu IV/5, si më poshtë:

“Kreu IV/5

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë

institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2018 deri në datën 19 shtator 2018.

2. Kandidatët që aplikojnë në LAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë Bachelor apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezultoi i akredituar në momentin e diplomimit të studentit; ose

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë Bachelor ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA.

4. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germen “a”, të pikës 3 të këtij kreu, në një program të ciklit të parë Bachelor apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akredituar në momentin e transferimit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë Bachelor apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akredituar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

5. Transferimi i studimeve në ciklin e dytë mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kriterëve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga LAL.

6. LAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

7. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë ose fotokopje të saj të njëzuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë



vendit, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njëzuar me origjinalin ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;

b) Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njëzuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, paraqesin dëftesën e pjekurisë (original ose në rast fotokopjeje të saj, të njëzuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

c) Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 9 bashkëlidhur këtij udhëzimi);

d) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

e) Dy fotografi personale.

8. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri;

b) Curriculum Vitae;

c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.

9. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:

a) Kërkesën drejtuar institucionit të arsimit të lartë (LAL) për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;

c) Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.

Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin original të çregjistrimit, nga LAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. emrin, atësinë, mbiemrin;

ii. datëlindjen;

iii. vendlindjen;

iv. shtetësinë;

v. numrin e matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;

vi. emërtimin e LAL-së dhe të programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;

vii. numrin e matrikullimit, si dhe emërtimin e programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në LAL-në nga ku transferohet;

viii. ciklin dhe formën e studimit;

ix. datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga LAL-ja nga ku transferohet;

x. datën e ndërprerjes së studimeve.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

a) Fotokopje e njëzuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MASR-ja/QSHA-ja.

b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera, dhe/ose e krediteve përkatëse.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Çaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.



c) Kandidati nga komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

12. Studentët e padiplomuar të ish-shkollës së lartë universitare, jopublike “Justicia”, e mbyllur me vendimin nr. 70, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike “Justicia”, Tiranë”, kanë të drejtë, vetëm në vitin akademik 2018–2019, të aplikojnë për transferim të studimeve të ndërprera në programe studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj. Nuk mund të transferojnë studimet ata individë që kanë filluar studimet (regjistruar) përpara licencimit të programit respektiv të studimit ose nuk janë pajisur me numër matrikullimi nga Qendra Shërbimeve Arsimore (ish-Agencia Kombëtare e Provimeve), sipas kërkesës së SHLJ-së “Justicia”. LAL-të pritëse komunikojnë me shkrim me QSHA-në për çdo sqarim lidhur me këtë çështje.

Dokumentacioni që do të dorëzojë është i parashikuar si për studentët e tjerë që aplikojnë për transferim studimesh.

Pranimet do të kryhen brenda numrit të kuotave të përgjithshme të deklaruara për programin e studimeve në LAL-në ku aplikohet.

13. Pranë departamenteve të njëjësive kryesore të LAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga LAL-ja.

14. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë LAL-së përkatëse, në datat e deklaruara nga LAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afatëve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

15. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në LAL-në publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i kërkon LAL-ve ta regjistrojë atë.

16. LAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimin dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto

njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe LAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

17. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jofitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe LAL-së, si dhe faqet web përkatëse, të plotësuara sipas tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në shtojcën nr. 11 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

18. LAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2018.

19. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga LAL-ja brenda datës 1 tetor 2018. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të LAL-së, si dhe faqet web përkatëse, e plotësuara sipas tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në shtojcën nr. 9 të këtij udhëzimi.

LAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2018. Në listën e publikuar nga ana e LAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

20. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në LAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. LAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

21. LAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2018.

22. Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarisë mësimore nga data 10 tetor 2018 deri në datën 13 tetor 2018. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2018.



23. LAL-të, brenda datës 19 nëntor 2018, dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga LAL-ja rregjistrimin tyre.

24. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.”.

VII. Pas kreut IV/5 të udhëzimit shtohet kreu IV/6, si më poshtë:

“Kreu IV/6

Pranimet në ciklin e tretë të studimeve “master ekzekutiv”

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv” me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore, në LAL-të publike deri në datën 12 tetor 2018 dhe në LAL-të jopublike deri në datën 19 tetor 2018.

2. Brenda datës 22 tetor 2018, LAL-të publike dhe brenda datës 29 tetor 2018 LAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, si dhe në faqet web të LAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në LAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. LAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimin, brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të LAL-së publike deri në datën 30 tetor 2018 dhe deri në datën 6.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të LAL-së jopublike.

5. LAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj web, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 6 nëntor 2018 për LAL-të publike dhe 8 nëntor 2018 për LAL-të private.

6. Njësitë kryesore të LAL-ve organizojnë procesin e pranimi dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimi sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

7. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë,

me kohë të plotë, “master ekzekutiv”, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018–2019, sipas kuotave respektive të deklaruara nga LAL-të, realizohet në bazë të përgjedhjes së bërë nga LAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, të përcjella më parë QSHA-së e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të bëra paraprakisht publike.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të tretë “master ekzekutiv”, kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë “master i shkencave”/ “master i arteve”, i cili rezultoi i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit; ose

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë “master i shkencave”/ “master i arteve”, i licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, brenda muajit dhjetor 2018.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve “master i shkencave”/ “master i arteve” të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve “master i shkencave”/ “master i arteve” të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lësuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.

b) Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve Bachelor të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve Bachelor të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë.

c) Vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.



d) Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

b) Curriculum Vitae;

c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

c) Kandidati nga komuniteti rom/ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të LAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi “master ekzekutiv” me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga LAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë LAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga LAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në LAL-në publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja, pas verifikimit i kërkon LAL-ve ta çregjistrojë atë.

15. LAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurritit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecures normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe LAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. LAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga LAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënskruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.”.

VIII. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla



SHTOJCA NR. 2

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____,
emri, atësi, mbiemri

Me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarami të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore, dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Emër, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . ____



SHTOJCA NR. 3

Tiranë, më _____._____.2018

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri, atësia, mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të parë/profesional/integruar i ciklit të dytë
në LAL _____.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët

a) Me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

☐ Republika e Kosovës;☐ Mal i Zi;☐ Maqedoni;☐ Preshevë;☐ Bujanovci;☐ Medvegja;

b) E buaj

Me shtetësi _____

Gjuhë amtare _____

Me arsim të mesëm _____

Adresë aktuale _____

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituar dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe të regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues për vitin akademik 2018–2019.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma



SHTOJCA NR. 4

Tiranë, më _____.2018

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri, atësia, mbiemriMe kartë identiteti/pasaportë nr. _____, e-mail _____
celular _____.Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në LAL
_____.

1. Deklaroj se jam (të shënohet me “x” kategoria):

- ☐ PAK;
☐ Jetim;
☐ Rom;
☐ Egjiptian.

2. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallëm fitues për vitin akademik 2018–2019.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përgjegjëdhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma



SHTOJCA NR. 5

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____,
me kartë identiteti, pasaportë nr. _____,

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues, për vitin akademik 2018–2019.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore, dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma:

Firma:

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . _____



SHTOJCA NR. 6

Tiranë, më _____.2018

Formular aplikimi

Unë i/e nënshtetësi/a _____, lindur më _____
emri, atësia, mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____, tel.: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë / tretë:

- ☐ Master profesional
☐ Master i shkencave/master i arteve të bukura
☐ Master Ekzekutiv

në _____, në LAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit**B. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):**

- ☐ Republika e Kosovës;
☐ Mal i Zi;
☐ Maqedoni;
☐ Preshevë;
☐ Bujanovci;
☐ Medvegja;

C. Nga kategoritë e veçanta (PAK, të shënohet kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):_____.**D. Shtetas i huaj**

Gjuha amtare _____ . Shtetësia _____

Emri i universitetit _____

6. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në vitin akademik 2018–2019 në ciklin përkatës të studimit.

7. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të LAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

8. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institutin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionin e arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

9. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.



10. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore, dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit
Firma

Emër, mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin
Firma



SHTOJCA NR. 7

Tiranë, më _____._____.2018

Formular aplikimi

Unë i/e nënsbërkruari/a _____, lindur më _____

emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____, tel.: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

- ☐ Me karakter profesional 2-vjeçar
- ☐ Ciklit të parë Bachelor
- ☐ Integruar të ciklit të dytë “master i shkencave”
- ☐ Ciklit të dytë “master profesional”
- ☐ Ciklit të dytë “master i shkencave”/ “master i arteve”
- ☐ Ciklit të tretë “master ekzekutiv”

në _____, në LAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Për program të dytë studimi**B. Për transferim studimesh**

1. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në vitin akademik 2018–2019 në ciklin përkatës të studimit.

2. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të LAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

4. Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore, dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit
Firma

Emër, mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin
Firma



SHTOJCA NR. 8

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe të vlerësimit.

	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji (Bachelor, PICD)	LAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jofitues
											Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale	
1															
2															
3															
...															

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe të vlerësimit.

N.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	LAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015-2016	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jofitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	Ej.	Pikët totale	
1																
2																
3																
...																



SHTOJCA NR. 9

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe të vlerësimit.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015-2016	Kreditet (ECTS) të e grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jofitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale	
1																
2																
3																
...																

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe të vlerësimit.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kryer më parë dhe lloji	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jofitues
											Kriteri 1	Kriteri 2		Pikët totale	
1															
2															
....															

**VENDIM****Nr. 55, datë 20.7.2018****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME POLIÇAN**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan për licencim për efekt përfundimit të shtimit të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura dhe ndryshimit të emrit të shoqërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan, me NUIS: J69102446I është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 7, datë 3.2.2017, “Për rinovim licence Ujësjiellës Poliçan”, me vlefshmëri 4-vjeçare deri në datën 2.2.2021;

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan, me anë të shkresës nr. 392 prot., të datës 28.6.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për arsye të shtimit të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura;

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për shtim të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura, konkretisht:

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur i plotë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan, me:

Drejtues ligjor: Klajdi Brahimi

Drejtues teknik: Klajdi Brahimi

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Poliçan;

4. Kjo licencë është e vlefshme deri më 2.2.2021.

5. Vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 7, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Poliçan” dhe nr. 23, datë 7.6.2017, “Për një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 3.2.2017, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Poliçan’”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM**Nr. 56, datë 20.7.2018****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TARIFE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT-KUÇOVË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe vendimit të



Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 20.7.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë, përkatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësiave ligjore, konkretisht: neni 14, neni 22 dhe neni 33, i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjiellës-kanalizime, në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht;

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale;

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë ka aplikuar pranë ERRU-së me shkresën nr. 816 prot., datë 28.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Faqe| 8502

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM Nr. 57, datë 20.7.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TARIFE TË SHOQËRISË UJËSJIJELLËS-KANALIZIME LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 20.7.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Librazhd, përkatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësiave ligjore, konkretisht: neni 14, neni 22 dhe neni 33, i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjiellës-kanalizime, në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe



kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht;

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 19, datë 11.5.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale;

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 171 prot., datë 29.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Librazhd për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndrçim Shani

VENDIM Nr. 58, datë 20.7.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TARIFE TË SHOQËRISË UJËSJETLLËS-KANALIZIME POLIÇAN

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin,

largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 20.7.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Poliçan, përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësiive ligjore, konkretisht, neni 14, neni 22 dhe neni 33, i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjetllës-kanalizime, në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht;

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Poliçan është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 55, datë 20.7.2018, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Poliçan”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale;

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Poliçan ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 389 prot. datë 28.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për



përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Poliçan për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Poliçan për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 59, datë 20.7.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TARIFE TË SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”,

Faqe | 8504

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 7.20.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë, përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësiave ligjore, konkretisht: neni 14, neni 22 dhe neni 33, i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjetllës-kanalizime, në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht;

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale;

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 983 prot., datë 27.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastrë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 364 lekë